



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:057115

Datë: 07.03.2025

Numri i dokumentit: 06953411

C.nr.672/23

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtaren Adelina Jusufi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve M. I. dhe K. M., nga P..., i përfaqësuar me autorizim nga shoqëria e avokatëve “Klinaku Associates” me seli në Prishtinë, Ulpiana C-2 2/6, kundër të paditurës Komuna e Podujevës-Drejtoria e Arsimit në Podujevë, rr.“Nuhi Gashi” p.n., me objekt kontesti, kompensimin e 70% të shpenzimeve transportit rrugor (udhëtimit), me vlerë të kontestit: 744.24 €, jashtë seance me dt: 07.03.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve M. I. dhe K. M..

II. Detyrohet e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria e Arsimit, që paditësve

- M. I. t’ia kompenson në emër të 70% të shpenzimeve të transportit rrugor (udhëtimit) dhe atë për 146 ditë pune, në shumën prej 245.2 € me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 06.03.2023 (data e parashtrimit të padisë), deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.
- dhe K. M. t’ia kompenson në emër të 70% të shpenzimeve të transportit rrugor (udhëtimit) dhe atë për 172 ditë pune, në shumën prej 144.48 € me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 11.11.2024 (data e precizimit të padisë), deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

III. Refuzohet kërkesa e paditëses K. M. në emër të 70% të biletës së udhëtimit dhe atë për 422 ditë pune në shumën 354.48 € **si e pabazuar**.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve, të ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 99.00 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi, I. M. përmes të autorizuarit të tij si në hyrje, me datën 06.03.2023 ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Podujevës-Drejtoria e Arsimit-DA, të cilën e ka precizuar me datën 11.11.2024, me të cilën ka kërkuar, pagesën e 70% të shpenzimeve të udhëtimit-transportit rrugor për ditët e pranisë në punë, edhe për paditësen K. M. ashtu që ka kërkuar që paditësve t'i paguhet shuma e cekur si në hyrje të këtij Aktgjykimi.

Ka shtuar se paditësi I. M. është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura dhe punon si mësimdhënës në SH.F.M.U.“Zahir Pajaziti” në Podujevë, ndërsa K. M. është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura dhe punon si mësimdhënës në SH.F.M.U.“Dr. Ibrahim Rugova” në Podujevë. Ka theksuar se, e paditura përkundër obligimeve të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e dt. 18.04.2017 dhe 22.01.2021 komform dispozitave të nenit 35 par. 5 të marrëveshjeve të cekuara, Ligjit të Punës dhe Kontratës Individuale, nuk e ka bere kompensimin e 70 % të transportit rrugor (udhëtimit) për ditët e pranisë në punë prej datës 01.01.2019 e deri ne parashtrimin e kësaj padie. Në precizimin e kërkesëpadisë të paraqitur me dt. 11.11.2024 e ka saktësuar shumën e kërkuar për paditësit, ashtu që për paditësin Ibrahim Mehmeti ka kërkuar shumën e përgjithshme 245.28 € për 146 ditë pune ($146 \times 2.40 = 350.4€$; $350.4€ - 30\% = 245.28€$), ndërsa për paditësen K. M. ka kërkuar shumën e përgjithshme 498.96 € për 594 ditë pune ($594 \times 1.20 = 712.8€$; $712.8€ - 30\% = 498.96€$). Andaj, i ka propozuar gjykatës që t'a aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar dhe, t'a detyroj të paditurën që të bëjë kompensimin e 70% të transportit rrugor për ditët e pranisë në punë, në emër të këtyre kërkesave.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi dhe të plotësimit të saj të datës 11.11.2024, i ka pohuar faktet vendimtare duke theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit sipas Kontratës Kolektive të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, ngase Komuna e Podujevës nuk ka buxhet për të bërë këto pagesa të shujtave të ushqimit. Në nenin 46 të KKA të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 është paraparë se MASHT dhe SBASHK-u, angazhohen bashkërisht me MF për ndarjen e mjeteve financiare për pagesën e obligimeve që rrjedhin nga neni 35 paragrafët 5,7 dhe 8 të kësaj kontrate, andaj e paditura nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve të arsimit. Në nenin 90.5 të LP-së vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara në kontratën kolektive, dhe në rastin konkret e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive. Më tej shton se shpenzimet e udhëtimit për paditësin I. M. duhet ti llogariten në relacionin Lupç i Poshtëm –Orllan dhe anasjelltas me çmim ditor prej 1 €- 30%, ndërsa paditëses K. M. kërkon që ti hiqen 422 ditë për shkake të parashkrimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që padia e paditësve ndaj komunës së Podujevës – Drejtorisë së Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, të refuzohet si e pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur

se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se e paditura i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se nuk është kontestues fakti se paditësit janë apo kanë qenë në marrëdhënie pune tek e paditura për disa vite përvojë pune, sikurse nuk është kontestuese se e paditura nuk ia ka paguar paditësit kompensimin për shpenzimet e udhëtimit, për ditët e pranisë në punë për periudhën e kërkuar si më sipër, pasi që një gjë e tillë nuk kontestohet nga palët, e kjo vërtetohet dhe me provat materiale në shkresat e lëndës.

Andaj, gjykata, konform nenit 152 dhe 398 të LPK-së gjeti se, kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017 dhe 21.01.2022 konkretisht me nenin 35 par. 5 ku është paraparë se: *“Punonjësve arsimorë (anëtarë të SBASHK-ut) që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban. por këtë nuk e ka bërë e paditura edhe pse ka qenë e obliguar ta bëj.*

Po ashtu kjo është e rregulluar me Ligjin nr.03/L-212 e Punës, sipas nenit 90 par.4 të tij ku thuhet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se 3 (tri) vjet.”*, siç është dhe me këtë Kontratë (e cila ka qenë në fuqi konform nenit 45 par.2 të saj, deri me datën 22.01.2021), e që kjo çështje është rregulluar njëjtë dhe me dispozitat e nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë në fuqi nga data 22.01.2021 të cilat gjejnë zbatim në rastin e paditësit.

Gjykata, lidhur me lartësinë e kërkesëpadsisë së paditësit vendosi duke u bazuar në provat materiale dhe atë për paditësin M. I. siç janë: Kontratën e Punës nr.prot 1492 të datës 02.09.2019, Vërtetimit nr.prot:864/24 i dt: 05.11.2024, të lëshuar nga SH.F.M.U.“Zahir Pajaziti”, Orllan–Komuna e Podujevës, nga të cilët vërtetohet se paditësi për periudhën nga dt.01.01.2022 e deri me datë 21.11.2022 ka 146 ditë pune, Certifikata e Vendbanimit nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile i dt: 05.05.2021, si dhe Vërtetimi nga Kompania Private e Transportit privat “Dita”, për paditësin: M. I., për relacionin e udhëtimit dhe çmimin e biletës; ndërsa për paditësen K. M. siç janë: Kontratën e Punës nr. i reXH. 02.28-1754 të datës 01.09.2021, Vërtetimit nr.prot:800/24 i dt: 06.11.2024, të lëshuar nga SH.F.M.U.“Dr. Ibrahim Rugova”, Podujevë, nga të cilët vërtetohet se paditësi për periudhën nga dt.01.01.2019 e deri me datë 21.11.2022 ka 594 ditë pune, Certifikata e Vendbanimit nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile i dt: 17.03.2022, si dhe Vërtetimi nga Kompania Private e Transportit privat “Leli Trans”, për paditësin: K. M., për relacionin e udhëtimit dhe çmimin e biletës; me ç’rast kemi të bëjmë me dokumente të cilat kanë fuqi të plotë provuese, ndërsa, e paditura nuk e ka rrëzuar me prova materiale fuqinë provuese të këtyre dokumenteve, e gjithë kjo bazuar edhe në dispozitën e lart cituar të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, konkretisht nenit 35 par.5 të saj.

Gjykata, si në piken tre të dispozitivit vendosi, duke ju refuzuar pjesërisht e pabazuar kërkesa e paditëses K. M. në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit përtej shumës së aprovuar dhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2019 e deri me datë 31.10.2021, për 422 ditë pune meqë gjykata në kuptim të rrethanave të konstatuara me lart dhe duke e vlerësuar propësimin e të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, gjeti se kërkesa për këtë periudhë është e parashkruar. Kjo konform dispozitës së nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, (e cila dispozitë

ka karakterin prekluziv) ku lidhur me kërkesat në para nga marrëdhënia e punës është paraparë afati i parashkrimit ashtu që është përcaktuar se: *"Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës* Duke pasur parasysh se parashkrimi fillon të rrjedhë nga dita e parë pas ditës kur paditësi ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga i padituri, gjykata konstaton se në rastin konkret kemi parashkrim për pjesën e kërkesës së lartcekur. Në rastin konkret, për periudhën 01.01.2019 e deri me datë 31.10.2021, deri në precizimin e padisë me 11.11.2024, kanë kaluar mbi 3 vite, me çka është parashkruar pjesa e kërkesave për realizimin e 70 % të shpenzimeve të udhëtimit për ditët e pranisë në punë për këtë periudhë.

Gjykata, i konsideron si të papranueshme dhe të pabazuara pretendimet dhe kundërshtimet e paditurës se ajo nuk ka asnjë obligim ndaj paditësit me arsyetim se nuk ka buxhet për të bërë këto pagesa për çka edhe i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Ndërkaq gjykata i mori parasysh pretendimet e te paditurës sa i përket periudhës se parashkrimit, dhe periudhës në të cilën mësimi është zhvilluar online.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e palëve dhe provat tjera të ofruara, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes kontestimore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 të LPK-së, ndërsa lartësinë e tyre e mbështeti në Rregulloren e Tarifës së Avokatëve të Kosovës e vitit 2017, ndërsa për takse gjyqësore iu referua Udhëzimit Administrativ për Taksa Gjyqësore nr. 01/2017, ku në rastin konkret, e paditura u obligua që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 99.00 € dhe atë, në emër të përpilimit të padisë shumë prej 78.00 € dhe në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 21.00 €. Gjykata e refuzoi kërkesën e paditëses për kompensimin e parashtresës për plotësim të padisë, pasi që vlerësoi se është shpenzim i bërë pa fajin e të paditurës, duke pasur parasysh se paditësja të njëjtin plotësim është dashur ta paraqes me anë të padisë dhe për këtë arsye i është kthyer në plotësim padia. Po ashtu, gjykata vlerëson se paraqitja e padive të mangëta, plotësimi i të njëjtave pas kërkesës së gjykatës dhe kërkimi i shpenzimeve për këto plotësime është keqpërdorim i të drejtave në procedurë.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

Gjykata Themelore Prishtinë-Dega Podujevë
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.672/23, datë 07.03.2025

Gjyqtarja
Adelina Jusufi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.